

Sigurimi i Pronës

Sigurimi është një formë e manaxhimit të riskut që vjen nga një situatë e panjohur, një kontratë në bazë të së cilës një person/kompani, kalon rrezikun e mundshëm të një dëmi/humbje financiare tek një kompani sigurimi, përkundrajt pagesës së një shume që quhet prim sigurimi.

Sigurimi i pronës mbron interesat e klientëve kredimarrës dhe jo-kredimarrës pranë Banka e Tiranës, në rast ndodhje dëmi në pasurinë e siguruar nga rreziqe bazë si Zjarr&Rreziqe shtesë dhe Tërmet.

Karakteristikat e sigurimit të pronës:

1. Sigurimi i pronës për huanë mbron interesat e klientëve kredimarrës të Bankës së Tiranës në rast të dëmtimit të pasurisë së vendosur si kolateral pranë bankës;
2. Sigurimi vullnetar i pronës mbron interesat e klientëve në rast të dëmtimit të pasurisë së tyre;

I **siguruari** mund të jëtë cdo individ ose person juridik, të cilët kanë interes pasuror mbi objektin që do të sigurohet.

Shuma e sigurimit përcaktohet në policë sipas kriterëve të përcaktuara nga Banka apo Klienti:

1. Vlera e zëvendësimit (sipas raportit të vlerësimit të pasurisë);
2. Vlera e tregut (sipas raportit të vlerësimit të pasurisë ose cmimeve referencë të tregut të pasurivë të paluajtshme).

Primi i sigurimit llogaritet sipas llojit të pasurisë, vlerës së pasurisë, llojet e mbulimit dhe periudhës së sigurimit. Primi i sigurimit për efekt kredie paguhet cdo vit sipas periudhës së sigurimit 1-vjecare.

Përfituesi i policës së sigurimit përcaktohet në policë.

Dëmshpërblimi paguhet nga Kompania e Sigurimit në rast vërtetimi të ngjarjes së siguruar, duke rikthyer objektin e siguruar në gjëndjen e mëparshme ose pagesë në vlerën monetare.

Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, i Siguruari duhet:

- Të njoftojë menjëherë me shkrim Siguruesin duke specifikuar rrethanat e ngjarjes, dhe të njoftojë organet e Rendit dhe ato të mbrojtjes nga zjarri (PMNZSH);
- Të shmangë ose minimizojë humbjet ose dëmtimet me sa është e mundur;
- Të lejojë Siguruesin të hetojë lidhur me shkakun dhe Shumën e humbjes si dhe masën e dëmshpërblimit;
- Nëse është e mundur të mos ndryshojë asgjë nga vendngjarja pa miratimin e Siguruesit.

Pjesa e zbritshme është risku i mbajtur nga i Siguruari në rast dëmi. Në cdo rast dëmi të trajtueshëm, Siguruesi do të zbresë nga dëmshpërblimi i llogaritur pjesën e zbritshme të përcaktuar në policën e sigurimit.

Kushtet e përgjithshme të sigurimit shoqërojnë cdo policë sigurimi dhe duhen disponuar, kuptuar dhe pranuar nga i Siguruari.